L I G J
Nr.8532, datë 14.10.1999

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË TË ZHVILLIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN E MIKROKREDISË"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë së zhvillimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin e mikrokredisë".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.2458, datë 18.10.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

NUMRI I KREDISË 3253 ALB

MARRËVESHJE E KREDISË PËR ZHVILLIM

- Projekti i Mikroredisë -

MARRËVESHJE, datë 18 korrik 1999, midis Shqipërisë (Humarrësi) dhe SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (Shoqata).

MEQË: (A) Huamarrësi, i kënaqur me përshtatshmërinë dhe përparësinë e Projektit të përshkruar në Shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje, ka kërkuar nga Shoqata që ta ndihmojë në financimin e Projektit;

(B) Pjesët C dhe D të Projektit do të zbatohen nga Huamarrësi dhe Pjesët A dhe B të Projektit do të zbatohen respektivisht nga Fondi i Financës Rurale (FFR) dhe Fondacioni Besa (FB), të dy me ndihmën e Humarrësit dhe, si pjesë e kësaj ndihme, Huamarrësi do t'i dorëzojë FFR-së dhe FB-së pjesë të fitimeve nga Kredia sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje;

(c) Huamarrësi ka për qëllim të kontraktojë nga Agjencia Swiss për Zhvillim dhe Bashkëpunim një grant me një kapital fillestar prej dy (2) milion franga zvicerane për të ndihmuar në financimin e Pjesës A (1) të Projektit me kushtet dhe konditat të përcaktuara në një marrëveshje midis Huamarrësit dhe Angjencisë Swiss për Zhvillim dhe bashkëpunimin (SDC Marrëveshje Granti); dhe

MEQË Shoqata ka pranuar, në bazë, ndër të tjera, të pohimeve të misipërme, që t'i akordojë Huamarrësit kredinë sipas kushteve dhe konditave të përcaktuara në këtë Marrëveshje;

PRANDAJ palët kontraktuese bien dakord për sa vijon:

Neni I

Kondidat e përgjithshme Përkufizimet

Pjesa 1.01 “Kondidat e Përgjithshme që u përkasin Marrëveshjeve mbi Kreditë për Zhvillim” të Shoqatës, nënshkruar me datën 1 janar 1985 (ndryshuar në 2 Dhjetor 1997), me përmirësimet e bëra më poshtë (Kondidat e Përgjithshme), përbëjnë pjesën integrale të kësaj Marrëveshjeje:

(a) Është shtuar një paragraf i ri (12) në Pjesën 2.01. që do të lexohet si më poshtë, dhe paragrafet ekzistues nga (12) deri (14) të Pjesës së përmendur për këtë arsye do të rinumërohen si paragrafe nga (13) deri (15):

12. ”Vend Pjesëmarrës” i referohet çdo vendi të kushtëzuar nga Shoqata të plotësojë kërkesat e vendosura në Pjesën 10 të Rezolutës nr.183 të Bordit Udhëheqës të Shoqatës, miratuar në 26 qershor 1996 dhe “Vende Pjesëmarrëse” i referohet, kolektivisht, të gjitha vendeve të tilla.

(b) Fjalia e dytë e Pjesës 5.01 e ndryshuar do të lexohet:

“Përveç kur Shoqata dhe Huamarrësi bien dakord ndryshe, nuk mund të bëhen tërheqje: (a) nga llogaria e shpenzimeve në territoret e çdo vendi që nuk është Vend Pjesëmarrës ose për artikuj të prodhuar në, ose shërbime të ofruara nga, territore të tilla; ose (b) për shkak të çdo pagese personave ose njësive, ose për çdo import mallrash, nëse një pagesë ose import i tillë, me dijeninë e Shoqatës, është i ndaluar nga një vendim i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, i marrë në Kreun VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.”

Pjesa 1.02. Përveç rasteve kur kërkohet, termat e përcaktuara në Kondidat e Përgjithshme dhe në Hyrjen e kësaj Marrëveshjeje kanë përcaktimet e caktuara dhe termat plotësuese që pasojnë, kanë këto përcaktime:

(a) ”FB” i referohet Fondacionit Besa, krijuar si një fondacion në përputhje me Kodin Civil të Huamarrësit dhe regjistruar në Gjykatën e Rrethit të Tiranës sipas Regjistrimit me nr.221 me 1 tetor 1998.

(b) ”Manuali Administrativ dhe Financiar i FB-së” i referohet manualit operacional adoptuar nga FB-ja sipas Seksionit 6.01 (e) të kësaj Marrëveshjeje.

(c) ”Manual Operacional i FB-së” i referohet manualit operacional që do të zbatohet nga FB-ja sipas Seksionit 6.01 (e) të kësaj Marrëveshjeje që udhëheq politikat dhe praktikat huadhnëse të FB-së sipas Pjesës B të Projektit.

(d) ”SHKK e regjistruar” i referohet një shoqate të regjistruar Kursim-Kredi në gjykatën e rrethit përkatës të huamarrësit dhe që vepron në përputhje me Ligjin e SHKP-së (siç do të quhet më poshtë), e cila plotëson kriteret ligjore përcaktuar në paragrafin 1 të seksionit IV të Kreut 4 të kësaj Marrëveshjeje.

(e) ”NJZP” i referohet njësisë së zbatimit të projektit krijuar brenda Ministrisë së Financave të Huamarrësit me qëllim koordinimin e përgjithshëm për zbatimin e Projektit.

(f) ”FFR” i referohet Fondit të Financës Rurale, krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave të Huamarrësve nr.207, datë 28 prill 1999, si një fondacion sipas Kodit Civil të Huamarrësve dhe regjistruar në Gjykatën e rrethit të Tiranës, sipas Regjistrimit nr.1553, datë 18.5.1999.

(g) ”Manuali Adimnistrativ dhe Financiar i FFR-së” i referohet manualit administrativ dhe financiar zbatuar nga FFR-ja sipas Seksionit 6.01 (e) të kësaj Marrëveshjeje.

(h) ”Manuali Operacional i FFR-së” i referohet manualit operacional që do të zbatohet nga FFR-ja sipas Seksionit 6.01 (c) të kësaj Marrëveshjeje që udhëheq politikat dhe praktikat huadhënëse të FFR-së sipas Pjesës A të Projektit.

(i) ”Rregullat themelore të FFR-së ” i referohen rregullave themelore për operacionet e FFR-së, përcaktuar nga Bordi i Drejtorëve etj.

(j) ”Përfituesi Rural” i referohet një individi fermer privat ose një individi sipërmarrës privat, i cili është anëtar i një SHKK-je të regjistruar.

(k) ”Ligji i SHKK” i referohet Ligjeve të Shoqatave të Kursim-Kredisë nr.8089, datë 21 mars 1996.

(l) ”Rregullat themelore të SHKK-së” i referohen rregullave themelore që do të vendosen kohë pas kohe nga Huamarrësi ose ndonjë organ shtetëror rregullator për SHKK-në për Operacionet Financiare të SHKK-së, siç është rënë dakord me Shoqatën.

(m) ”Llogari e posaçme” i referohet llogarisë refruar në Seksionin 2.02 (b) të kësaj Marrëveshjeje.

(n) ”Marrëveshje Ndihmëse I” i referohet marrëveshjes që do të kryhet midis Huamarrësit dhe FFR-së sipas Seksionit 3.01 (c) të kësaj Marrëveshjeje, sepse e njëjta mund të rregullohet herë pas here, dhe ky kusht përfshin të gjithë kapitujt e Marrëveshjes Ndihmëse I.

(o) ”Marrëveshje ndihmëse II” i referohet marrëveshjes së arritur midis Huamarrësit dhe FB-së sipas Seksionit 3.01 (d) të kësaj Marrëveshjeje, sepse e njëjta mund të rregullohet herë pas here, dhe ky kusht përfshin të gjithë kapitujt e Marrëveshjes Ndihmëse II.

(p) ”Kredia e SHKK-së” i referohet një kredie të dhëne ose që mendohet t’i jepet një përfituesi Rural nga SHKK-ja e regjistruar për një Nënprojekt I nga një shumë e barasvlefshme e fitimeve të kredisë dhënë një shoqate të tillë SHKK nga FFR-ja.

(q) ”Kredi Ndihmëse I” i referohet një kredie të dhënë nga Huamarrësi FFR me qëllim që t’i jepet SHKK-së, të regjistruara nën Marrëveshjen Ndihmëse I, sipas Seksionit 3.01 (c) të kësaj Marrëveshjeje.

(r) ”Marrëveshje Ndihmëse II” i referohet një kredie të dhënë nga Huamarrësi FB me qëllim që t’i jepet përfituesve Urban nën Marrëveshjen Ndihmëse II, sipas Seksionit 3.01 (d) të kësaj Marrëveshjeje.

(s) ”Kredi I” i referohet një kredie të dhënë ose propozuar t’i jepet nga FFR-ja një SHKK-je të regjistruar, me qëllim që t’i jepet një Përfituesi Rural për Nënprojektin I nga fitimet e barasvlefshme të kredisë dhënë FFR-së.

(t) ”Kredia II” i referohet një kredie të dhënë ose të propozuar t’i jepet nga FB-ja përfituesve urban për nënprojektin II nga fitimet e barazvlershme të kredisë dhënë FB-së.

(u) ”Nënprojekt I” i referohet një projekti të veçantë investimi për një aktivitet prodhues, i cili plotëson kriteret e specifikuara në Manualin Operacional të FFR-së , që do të zbatohet nga një Përfitues Rural, duke përdour fitimet e Kredisë së SHKK-së.

(v) ”Nënprojekti II” i referohet një projekti të veçantë investimi për një aktivitet prodhues, i cili plotëson kriteret e specifikuara në Manualin Operacional të FB-së, që do të zbatohet nga një Përfitues Urban duke përdorur fitimet e Kredisë II.

(w) ”Përfitues Urban” i referohet një sipërmarrësi individual urban ose një individi të vetëpunësuar që jeton në një zonë urbane.

(x) ”Lek” i referohet monedhës së Huamarrësit.

Neni II
Kredia

Pjesa 2.01. Shoqata pranon t’i japë Huamarrësit, sipas kushteve dhe konditave të përcaktuara ose të përmendura në Marrëveshjen e Dhënies së Kredisë për Zhvillim, një shumë në valutë të monedhave të ndryshme, baras me tetë milion e nëntëqind mijë të Drejta të Posaçme Tërheqëse (SDR 8,900.000).

Pjesa 2.02. (a). Shuma e Kredisë mund të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë në përputhje me dispozitat e Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje për:

(i) shpenzimet e bëra (ose, nëse Shoqata pranon të bëhet) sipas kostos së arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për Projektin e përshkruar në Kreun II të kësaj Marrëveshjeje (përveç Pjesës A (3) dhe pjesës B (2) të Projektit) dhe që do të financohen nga fitimet e Kredisë;

(ii) shumat e paguara (ose nëse Shoqata do të jetë dakord të paguhen) nga FFR-ja dhe

FB-ja për llogari të tërheqjeve të bëra respektivisht nga një SHKK e regjistruar nën Kredinë I ose një Përfituesi Urban nën Kredinë II për të plotësuar koston e arsyeshme të mallit, punës dhe shërbimit të kërkuar për një Nënprojekt I ose për një Nënprojekt II, në lidhje me të cilën është kërkuar tërheqja nga Llogaria e Kredisë.

(b) Huamarrësi duhet, për shkak të Projektit, të hapë dhe të mbajë një llogari depozite të veçantë në dollarë në një bankë tregtare me kushte dhe kondita të kënaqshme për Shoqatën, duke përfshirë një mbrojtje të përshtatshme nga ndryshimet e konfiskimet. Depozitat në dhe pagesat nga Llogaria e Posaçme do të bëhen në përputhje me parashikimet e Kreut (5) të kësaj Marrëveshjeje.

Pjesa 2.03. Data e mbylljes është 30 qershor 2005, ose një datë e mëvonshme e përcaktuar nga Shoqata. Shoqata menjëherë do të njoftojë Huamarrësin lidhur me datën e mëvonshme.

Pjesa 2.04. (a) Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një pagesë angazhimi mbi shumën principiale të Kredisë që nuk tërhiqet nga koha në kohë me një kamatë të caktuar nga Shoqata, duke filluar me 30 qershor të çdo viti, por duke mos tejkaluar kamatën e një gjysmë përqindshi (1/2 të 1 %) në vit.

(b) Pagesa e angazhimit do të shtohet: (i) gjashtëdhjetë ditë nga data e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje (data e shtimit), deri në datat respektive në të cilat shumat do të tërhiqen nga Huamarrësi nga Llogaria e Kredisë ose do të anulohen; dhe (ii) sipas kamatës së caktuar më 30 qershor, menjëherë para datës së fillimit të shtesës ose me një kamatë tjetër që pastaj mund të përcaktohet nga koha në kohë në përputhje me paragrafin (a) më sipër. Kamata e caktuar me 30 qershor në çdo vit do të aplikohet nga data e ardhshme e pagesës në atë vit të përcaktuar në Pjesën 2.06 të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Pagesa e angazhimit do të paguhet: (i) në vende të tilla që në mënyrë të arsyeshme do të kërkojë Shoqata; (ii) pa kufizime të çfarëdo lloji që mund të vedosen nga, ose në territorin e Huamarrësit; dhe (iii) në monedhë të përcaktuar në këtë Marrëveshje për nevojat e Pjesës 4.02 të Konditave të Përgjithshme ose në monedha të tjera të pranueshme që nga koha në kohë mund të përcaktohen ose të zgjidhen në përputhje me dispozitat e kësaj Pjese.

Pjesa 2.05. Huamarrësi do t'i paguajë Shoqatës një pagesë shërbimi me një kamatë prej tre të katërtat e një përqindi (3/4 e 1%) në vit të shumës principiale të Kredisë së tërhequr dhe të papaguar nga koha në kohë.

Pjesa 2.06. Pagesat e angazhimit dhe pagesat e shërbimeve do të paguhen dy herë në 15 janar dhe 15 korrik të çdo viti.

Pjesa 2.07. (a). Në përputhje me paragrafet e mëpshtme (b), (c) dhe (d). Huamarrësi do të ripaguajë shumën principiale të Kredisë në këstet gjysmëvjetore të paguara në çdo 15 janar dhe 15 korrik duke filluar nga 15 qershori 2009, dhe dke përfunduar me 15 janar 2039. Çdo këst deri dhe duke përfshirë këstin e paguar në 15 janar 2019 duhet të jetë një përqind (1%) të shumës principiale, dhe çdo këst pas kësaj date do të jetë dy përqind (2%) e shumës principiale.

(b) Kurdo që: (i) prodhimi i përgjithshëm kombëtar për frymë i Huamarrësit, i përcaktuar nga Shoqata, tejkalon për tre (3) vite rresht nivelin vjetor të caktuar nga Shoqata për kushtëzimin e përdorimit të burimeve të Shoqatës; dhe (ii) Banka do ta konsiderojë Huamarrësin të besueshëm për t'i dhënë kredi, dhe Shoqata, pas shqyrtimit dhe miratimit nga Drejtorët Ekzekutivë të Shoqatës dhe pasi ata të kenë shqyrtuar zhvillimin e ekonomisë së Huamarrësit, mund të ndryshojë shlyerjen e kësteve sipas paragrafit të mësipërm (a):

(A) Duke i kërkuar Huamarrësit të paguajë dy herë shumën e çdo kësti të tillë deri sa të shlyhet e gjithë shuma principiale e kredisë; dhe

(B) Duke i kërkuar Huamarrësit të fillojë shlyerjen e shumës principiale të Kredisë si pagesë e datës së gjysmës së parë të vitit referuar në paragrafin (a) të mësipërm që është gjashtë muaj (6) ose më shumë pas datës në të cilën Shoqata njofton Huamarrësin se kanë ndodhur rastet e theksuara në këtë paragraf (b), duke shtuar se do të ketë një periudhë minimale favorizuese prej pesë (5) vjetësh për këtë shlyerje të principialit.

(c) Në qoftë se kërkohet nga Huamarrësi, Shoqata mund t'i ndryshojë modifikimet referuar në paragrafin (b) më sipër, kështu që në vend të një pjese të pagesës ose të të gjithë shtesës së pagesës, të paguhet interesi me një kamatë vjetore të caktuar në Shoqatën mbi shumën e përgjithshme të kredisë së tërhequr ose ende të papaguar nga koha në kohë, në qoftë se sipas mendimit të Shoqatës këto shqyrtime nuk do të ndryshojnë elementin e kredisë së dhuruar sipas modifikimeve të ripagesës së lartëpërmedura.

(d) Në qoftë se në çdo kohë pas modifikimit të kushteve sipas paragrafit (b) më sipër, Shoqata përcakton se gjendja ekonomike e Huamarrësit është keqësuar dukshëm. Shoqata, nëse i kërkohet nga Huamarrësi, mund të bëjë modifikime të tjera të kushteve të ripagesës për t'iu përshtatur afatit të caktuar të kësteve, siç parashikohet në paragrafin (a) më sipër.

Pjesa 2.08. Monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës caktohet si monedha e përdorshme për nevojat e Pjesës 4.02 të Kushteve të Përgjithshme.

Neni III
Zbatimi i Projektit

Pjesa 3.01. (a) Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj qëllimeve të Projektit të përcaktuara në Shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe për këtë qëllim:

(i) do të realizojë Pjesët C dhe D të projektit nëpërmjet Nj.Z.P. me efikasitetin dhe zellin e duhur dhe në përputhje me praktikat e përshtatshme administrative, financiare, bankare, kontabilitetit, bujqësore dhe ambientale, dhe do të sigurojë menjëherë siç kërkohet fondet, pajisjet, shërbimet dhe burimet e tjera të nevojshme për Pjesët C dhe D të projektit; dhe

(ii) pa asnjë kufizim ose pengim të detyrimeve të tij të tjera sipas Marrëveshjes, do të sigurojë që FFR-ja dhe FB-ja do të kryejnë respektivisht Pjesën A dhe B të Projektit me efikasitetin dhe zellin e duhur dhe në përputhje me praktikat e përshtatshme administrative, financiare, bankare, kontabilitetit, bujqësore dhe ambientale dhe do të ndërmarrë ose do të sigurojë që të ndërmerren të gjitha veprimet, përfshirë sigurimin e fondeve, pajisjeve, shërbimeve dhe burimeve të tjera të nevojshme ose të përshtatshme për ta bërë të mundur që FFR-ja dhe FB-ja të kryejë detyrime të tilla, dhe nuk do të ndërmarrë ose nuk do të lejojë të ndërmerret ndonjë veprim që do të parandalonte ose do të ndërhynte në kryerjen e detyrimeve të tilla.

(b) Pa kufizim në dispozitat e paragrafit (a) të këtij Seksioni dhe me përjashtim, kur Huamarrësi dhe Shoqata bien dakord ndryshe, Huamarrësi do të kryejë Pjesët C dhe D të projektit dhe do të bëjë të mundur që FFR-ja dhe FB-ja të kryejnë respektivisht pjesën A dhe pjesën B të Projektit në përputhje me Programin e Zbatimit të përcaktuar në Shtojcën 4 të kësaj Marrëveshjeje.

(c) Për nevojat e Pjesës A të Projektit, Huamarrësi do të bëjë disponibël tek FFR-ja fitimet e Kredisë alokuar kohe pas kohe në kategoritë (1), (3) (a) dhe (5) (a) të pasqyrës përcaktuar në paragrafin 1 të Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje sipas një Marrëveshjeje Ndihmëse që do të realizohet midis Huamarrësit dhe FFR-së sipas kushteve dhe konditave të pëlqyeshme për Shoqatën përfshirë, por jo e kufizuar, kushtet dhe konditat e përcaktuara në seksionin II të Shtojcës 4 të kësaj Marrëveshjeje.

(d) Për nevojat e Pjesës B të Projektit Huamarrësi do të verë në dispozicion të FB-së fitimet e Kredisë alokuar kohë pas kohe në Kategoritë (2) dhe (3) (b) të pasqyrës përcaktuar në paragrafin 1 të Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje sipas një marrëveshje ndihmëse që do të realizohet midis Huamarrësit dhe FB-së sipas kushteve dhe konditave të pëlqyeshme për Shoqatën përfshirë, por jo të kufizuar) kushtet dhe konditat e përcaktuar në Seksionin III të Shtojcës 4 të kësaj Marrëveshjeje.

(e) Huamarrësi do të ushtrojë të drejtat e tij sipas Marrëveshjes Ndihmëse I dhe II në mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e Huamarrësit dhe të Shoqatës dhe që do të plotësojë synimet e Kredisë, përveç kur Shoqata bie dakord ndryshe. Huamarrësi nuk do të transferojë, ndryshojë, abrogojë, ose heq dorë nga Marrëveshja I dhe II Plotësuese ose nga ndonjë dispozitë e

saj.

Pjesa 3.02. Përveç kur Shoqata bie dakord ndryshe, prokurimi i mallrave, dhe shërbimet e këshilluesve të nevojshëm për Projektin dhe që do të financohen nga fitimet e Kredisë, do të kryhen në përputhje me dispozitat e Shtojcës 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Pjesa 3.03. Për qëllimet e Pjesës 9.07 të Konditave të Përgjithshme dhe pa asnjë përjashtim përveç kësaj, Huamarrësi:

(a) do të përgatisë në bazë të udhësuesve të pranueshme nga Shoqata, dhe të pajisë shoqatën jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së mbylljes, ose më vonë se kjo datë siç mund të jetë rënë dakord për këtë qëllim midis Huamarrësit dhe Shoqatës, me një plan për të garantuar arritjet në vazhdim të objektivave të Projektit; dhe

(b) do t'i ofrojë Shoqatës një rast të arsyeshëm për të shkëmbyer mendime me Huamarrësin për planin e përmendur.

Neni IV
Konventat financiare

Pjesa 4.01 (a). Huamarrësi nëpërmjet Nj.Z.P. duhet të mbajë një sistem menaxhimi financiar, duke përfshirë regjistrimet dhe llogaritë dhe duhet të pregatisë konfermat financiare, të gjitha këto sipas standardeve të kontabilitetit të pranueshme për shoqatën, të përpikta dhe të mjaftueshme për të pasqyruar veprimet, burimet dhe shpenzimet që lidhen me projektin.

(b) Huamarrësi me anë të Nj.Z.P.:

(i) do të mbajë dokumentet dhe llogaritë, referuar në paragrafin (a) të këtij seksioni, përfshirë ato për Llogarinë e veçantë për çdo vit fiskal të revizionuar, sipas parimeve të përshtatshme revisionuese, të aplikuara me përpikëri, nga revisionues të pavarur të pranueshëm për shoqatën.

(ii) do të pajisë Shoqatën menjëherë sa të jenë të gatshme, por në asnjë rast jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të vitit, (A), kopjet e noterizuara të konfermave financiare referuar në paragrafin(a) të këtij Seksioni për këtë vit dhe (B) një opinion i deklarimeve, regjistrimeve dhe llogarive, si dhe raportin e oditit nga oditorët e përmendur, me përmasa dhe hollësi të tilla që i kërkon Shoqata në mënyrë të arsyeshme dhe

(iii) do të pajisë herë pas here Shoqatën me informacione të tjera lidhur me dokumentet, llogaritë dhe revizionet e përmendura në përputhje me kërkesat e arsyeshme që Shoqata mund të kërkojë herë pas here.

(c) Për të gjitha shpenzimet në lidhje me të cilat janë bërë tërheqjet nga llogaria e Kreditit bazuar në gjendjen e shpenzimeve Huamarrësi:

(i) do të mbajë ose do të sigurojë mbajtjen në përputhje me paragrafin (a) të këtij Seksioni, dokumentet dhe llogaritë mbi shpenzime të tilla;

(ii) do të sigurojë që të gjitha dokumentet (kontratat, kërkesat, faturat, vërtetimet dhe dokumentet e tjera), që vërtetojnë shpenzimet, të ruhen të paktën për një periudhë një vjeçare pasi Shoqata të ketë marrë raportin e revizionit për vitin fiskal në të cilin tërheqja e fundit është bërë nga Llogaria e Kredisë; dhe

(iii) do të lejojë përfaqësuesit e Shoqatës që të kontrollojnë dokumentacionin dhe;

(iv) do të garantojë që dokumente të tilla dhe llogaritë janë përfshirë në oditin vjetor referuar në paragrafin (b) të këtij seksioni dhe se raporti i një oditi të tillë mban një opinion të pavarur nga oditorët në fjaë në se deklaratat për shpenzimet të paraqitura gjatë vitit të tillë fiskal, së bashku me procedurat dhe kontrollet e brendshme të përdorura në përgatitjen e tyre, mund të jenë bazë për të vërtetuar tërheqjet përkatëse.

Seksioni 4.02 (a) Pa kufizim në dispozitat e Seksionit 4.01 të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi duhet të kryejë një plan veprimi të pranueshëm për Shoqatën për fuqizimin e sistemit të menaxhimit financiar të referuar në paragrafin(a) të seksionit në fjalë 4.01, me qëllim që t'i lejojë Huamarrësit, jo më vonë se 31 dhjetori i vitit 2000 ose në një datë të mëvonshme që do të

miratojë Shoqata, të pregatisë raportet tremujore të menaxhimit të projektit, të pranueshme për Shoqatën.

(i) (A) të përcaktojë burimet aktuale dhe përdorimet e fondeve për Projektin, për të dyja periudhat kumulative dhe periudhat që mbulon raportin në fjalë, dhe burimet e parashikuara dhe përdorimet e fondeve për projektin për periudhën gjashtë mujore sipas periudhës që mbulon raportin në fjalë, dhe (B) të tregojë veçmas shpenzimet e financuara nga fitimet e kredisë gjatë periudhës së mbuluar nga raporti në fjalë dhe shpenzimet e propozuara për t'u financuar nga fitimet e kredisë gjatë periudhës gjashtëmujore, sipas periudhës së mbuluar nga raporti në fjalë;

(ii) (A) të përshkruajë progresin fizik në zbatimin e projektit, për periudhën kumulative dhe periudhën e mbuluar nga raporti në fjalë dhe (B) të shpjegojë ndryshimet midis objektivave zbatuese, të parashikuara më parë dhe ato aktuale dhe;

(iii) të përcaktojë statusin e prokurimit, sipas projektit dhe shpenzimet sipas kontratave të financuara nga fitimet e kredisë si në çdo fund periudhe të mbuluar nga raporti në fjalë.

(b) Me përfundimin e planit të veprimit referuar në paragrafin (a) të këtij seksioni, Huamarrësi duhet të pregatisë në përputhje me udhëzuesit të pranueshëm për Shoqatën dhe të pajisë Shoqatën jo më vonë se 45 ditë mbas përfundimit të secilit tremujor kalendarik me një Raport menaxhimi Projekti për këtë periudhë.

Seksioni 4.03 (a) Huamarrësi duhet të bëjë të mundur që FFR dhe FB të mbajnë dokumentet dhe llogaritë e mjaftueshme për të pasqyruar në përputhje me praktikat strikte të kontabilitetit veprimet e tij dhe kushtet financiare dhe të regjistrojë veçmas veprimet, burimet dhe shpenzimet që lidhen respektivisht me Pjesën A dhe B të Projektit.

(b) Huamarrësi do të bëjë të mundur që FFR-ja dhe FB-ja

(i) të kenë dokumentet e tyre, llogaritë dhe konfermat financiare (bilancet, gjendjet e të ardhurave dhe shpenzimet, si dhe gjendjet përkatëse) për secilin vit fiskal të revizionuar në përputhje me parimet revizionuese të përshtatshme të aplikuara me përpikëri nga oditorë të pavarur të pranueshëm për Shoqatën.

(ii) të pajisë Shoqatën sapo të jetë gati por në asnjë rast më vonë se gjashtë muaj mbas përfundimit të secilit vit: me (A) kopje të vërtetuara të llogarive të saj financiare për vitin kur është kryer, dhe (B) raportin e oditit të tillë nga oditorët në fjalë, me përmasa dhe hollësi të tilla që Shoqata i kërkon në mënyrë të arsyeshme; dhe

(iii) të pajisë shoqatën me informacione të tjera të tilla, që lidhen me këto dokumente, llogaritë dhe konfermat financiare dhe me revisionet e përmendura ,që Shoqata i kërkon kohë pas kohe në mënyrë të arsyeshme.

Neni V
Masat që mund të marrë Shoqata

Pjesa 5.01. Në përputhje me Seksionin 6.02 (1) të Konditave të Përgjithshme janë specifikuar ngjarjet e tjera të mëposhtme:

(a) Statuti i FFR-së, Manuali operacional i FFR-së, Manuali i administratës dhe i financës së FFR-së ose Rregullorja themelore e FFR-së duhet të jenë ndryshuar, pezulluar, abroguar, tërhequr ose nxjerrë jashtë përdorimit pasi ndikojnë materialisht dhe negativisht në veprimet dhe kushtet financiare të FFR -së ose mundësitë e tij për të realizuar Pjesën A të Projektit.

(b) Statuti i FB-së, Manuali operacional i FB-së, ose manuali i administratës dhe financës së FB-së do të jetë ndryshuar, anulluar abroguar, tërhequr pasi ndikojnë materialisht dhe negativisht në veprimet dhe kushtet financiare të FB-së ose në mundësinë e tij për të realizuar Pjesën B të Projektit.

(c) Me shumë se 10% e totalit të shumës principiale se sa outstanding (kapitali në qarkullim) i të gjitha kredive dhënë nga FFR-ja tek SHKK-të të regjistruara do të kenë një vonesë për një periudhë kohe prej më shumë se 60 ditë.

(d) Më shumë se 10% e totalit të shumës principiale se sa outstandig i të gjitha kredive

dhënë nga FB-ja tek Përfituesit Urban, do të kenë një vonesë për një periudhë kohe prej më shumë se 60 ditë.

(e) (i) Sipas nënparagrafit (ii) të këtij paragrafi, e drejta e huamarrësit për të tërhequr fitimet e SDC (grant) krijuar nga Huamarrësi për financimin e projektit do të ishin pezulluar, fshirë ose mbyllur tërësisht ose pjesërisht sipas termave (të marrëveshjes).

(ii) Nënparagrafi (i) i këtij paragrafi nuk do të aplikohet nëse Huamarrësi vendos me pëlqimin e Shoqatës që: (A) dyshimi, anullimi ose mbyllja nuk është shkaktuar nga dështimi i Huamarrësit për të realizuar ndonjë nga detyrimet e tij sipas një marrëveshjeje të tillë; dhe (B) fondet e mjaftueshme për projektin janë disponibël për Humarrësin nga burimet e tjera sipas termave dhe kushteve në përputhje me detyrimet e huamarrësve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Pjesa 5.02. Në përputhje me 7.01 (h) të Konditave të Përgjithshme, është specifikuar rasti tjetër i mëposhtëm që ndonjë rast i specifikuar në paragrafin (a), (b), (c) dhe (d) të seksionit 5.01 të kësaj Marrëveshjeje do të ndodhë.

Neni VI
Data e hyrjes në fuqi; Përfundimi

Pjesa 6.01. Rastet që pasojnë janë përcaktuar si kondita shtesë për efektshmërinë e Marrëveshjes së Kredisë për Zhvillim në kuadër të përcaktimit të Pjesës 12.01 (b) të Konditave të Përgjithshme.

(a) Marrëveshja I Ndihmëse është zbatuar nga ana e Humarrësit dhe FFR-ja;

(b) Marrëveshja II Ndihmëse është zbatuar në emër të Huamarrësit dhe FB-ja;

(c) Sistemi i menaxhimit financiar referuar në Seksionin 4.01 (a) është fiksuar në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Shoqatën.

(d) Është zgjedhur një revizor i jashtëm i pëlqyeshëm për Shoqatën dhe;

(e) Manualet e procedurave dhe manualet e administratës dhe financës të pëlqyeshme për Shoqatën janë miratuar nga FFR-ja dhe FB-ja.

Seksioni 6.02. Çështjet e mëposhtme janë përcaktuar si shtesë brenda kuptimit të Seksionit 12.02 (b) të Konditave të Përgjithshme, për t'u përfshirë në opinionin ose opinionet me të cilat do të pajiset Shoqata.

(a) që Marrëveshja I Ndihmëse është autorizuar ose ratifikuar nga Huamarrësi dhe FFR-ja dhe i është detyruar ligjërisht Huamarrësit dhe FFR-së në përputhje me kushtet e saj; dhe

(b) që Marrëveshja II Plotësuese është autorizuar ose ratifikuar nga Huamarrësi dhe FB-ja dhe i është detyruar ligjërisht Huamarrësit dhe FB-së në përputhje me kushtet e saj.

Seksioni 6.03. Data nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së kësaj Marrëveshjeje përcaktohet për qëllimet e Seksionit 12.04 të Konditave të Përgjithshme.

Neni VII
Përfaqësuesi i Huamarrësit; Adresat

Pjesa 7.01. Ministri i Financave i Huamarrësit është caktuar si përfaqësues i Huamarrësit për qëllimet e Seksionit 11.03 të Konditave të Përgjithshme.

Seksioni 7.02. Adresat e mëposhtme janë përcaktuar për qëllimet e Seksionit 11.01 të Konditave të Përgjithshme:

Për Huamarrësin:
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tirana
Albania
Adresa telegrafikeTeleks:

4295 Komplan AB

Për Shoqatën:
International Development Association
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of Amerca

Adresa telegrafikeTeleks
INDEVAS248423 (MCI) ose
Washington, D.C.64145 (MCI)

PARA DËSHMITARËVE, palët nënshkruese, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë rënë dakord që kjo Marrëveshje të nënshkruhet me emrat e tyre përkatës në distriktin e Columbia, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në datën dhe vitin e lartshënuar.
SHQIPËRIA

Nga
Pandeli Majko
Përfaqësuesi i autorizuar

SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM
Nga
J.D.Wolfensohn
Nënpresidenti rajonal

SHTOJCA I
TËRHEQJA E FITIMEVE TË KREDISË

1. Tabela e mëposhtme përcakton Kategoritë e treguesve që do të financohen nga fitimet e Kredisë, shpërndarjen e shumës së Kredisë për çdo Kategori dhe përqindjen e shpenzimeve për treguesit që do të financohen në çdo Kategori:

Shuma e Kredisë së Alokuar (shprehur në SDR % e shpenzimeve Kategoriatë barasvlefshme)për t'u financuar	
(1)Kreditë për SHKK-të të regjistruar sipas Pjesës A të Projektit	3 440 000 100% e shumës së (3)disbursuar
(2)Kredi për përfituesit Urban sipas Pjesës B(2) të Projektit	3 440 000 100% të shumës së disbursuar
(3)Grantet për ndërtimin e kapacitetit	
(a)për FFR	150 000 100%
(b) FB	300 000 100%

(4)Pajisje sipas Pjesës 20 000100% të shpenzimeve
C dhe D të Projektittë huaja, 100% të shpenzimeve vendore (kostoja jashtë fabrikës) dhe 85% të shpenzimeve vendore për artikuj të tjerë të prokuruara në vend.

(5)Shërbimet e 520.000100%
konsulentëve
e trajnimet
(a)sipas pjesës A (1)të projektit100%
(b)sipas pjesës C të projektit100%
(c)sipas pjesës D të projektit100%
(6)Kostot operacionale
shtesë të Nj.Z.P. 90 000100%
(7)Të paalokuara940 000
TOTALI 8.900 000

2. Për nevojat e kësaj shtojce:
(a)termi “shpenzime të huaja” u referohet shpenzimeve në monedhën e çdo vendi tjetër përveç asaj të Huamarrësit për mallrat dhe shërbimet e furnizuara nga territori i çdo vendi tjetër përveç atij të Huamarrësit;
(b) termi "shpenzime lokale" u referohet shpenzimeve në monedhën e Huamarrësit ose për mallrat ose shërbimet e furnizuara nga territori i Huamarrësit; dhe
(c)termi “kostos operacionale e shtuar” kupton shpenzimet operacionale të Nj.Z.P., të cilat nuk kishin ndodhur pa Projektin dhe në to përfshihen, pa kufizime, kostot për: (i) pagat e personelit të Nj.Z.P. përveç atyre të punonjësve publikë të marrë për nevojat e Projektit; (ii) mirëmbajtjen dhe funksionimin e pajisjeve të prokuruara ose të përdorura për Projektin; (iii) pajisje konsumi për zyrat.
3. Shoqata mund të kërkojë të bëhen tërheqje nga Llogaria e kredisë në bazë të deklaratave të shpenzimeve për shpenzimet për: (i) Kredi për SHKK-të e regjistruara; (ii) kredi për Përfituesit Urban; (iii) grantet për ndërtimin e kapacitetit; (iv) mallra sipas kontratës që kushtojnë më pak se $ 50,000 ekuivalent për secilën; (v) shërbime sipas kontratës që nuk e kalojnë vlerën $ 100,000 të barazvlershme, dhe kontratat me konsulentë individualë që nuk e kalojnë vlerën $ 50,000 të barazvlershme dhe (vi) kosto operacionale e shtuar të Nj.Z.P; dhe (vii) trajnimi.

SHTOJCA 2
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Synimet e Projektit janë: (a) të garantojë shërbimet financiare për fermerët privatë dhe sipërmarrësit ruralë nëpërmjet krijimit të rrjetit të SHKK-së të qëndrueshme në zonat rurale dhe (b) të garantojë shërbime financiare për sipërmarrësit e vegjël individualë dhe të vetëpunësuar në zonat urbane nëpërmjet ngritjes së një institucioni të qëndrueshëm të mikrokredisë.
Projekti përbëhet nga pjesët që vijojnë, të cilat mund të modifikohen me marrëveshje midis Huamarrësit dhe Shoqatës nga koha në kohë për të arritur synimet:

Pjesa A: Rrjeti i SHKK-së Rurale
(1) Krijimi dhe zhvillimi i SHKK-ve në zonat rurale nëpërmjet garantimit të asistencës teknike dhe trajnimit.
(2) Forcimi i kapacitetit institucional të FFR-së me anë të granteve për ndërtimin e kapacitetit.
(3) Sigurimi i linjës së kreditit për FFR-në me qëllim dhënien e kredive tek SHKK-të e regjistruara.

Pjesa B: Mikrokredia Urbane

(1) Fuqizimi i kapacitetit institucional të Fondacionit Besa me anë të granteve për ndërtimin e kapacitetit.

(2) Sigurimi i linjës së kreditit për Fondacionin Besa me qëllim dhënien e kredisë tek përfituesi Urban.

Pjesa C: Mjedisi ligjor dhe rregullator

Përmirësimi i mjedisit ligjor dhe rregullator për mikrofinancën me anë të garantimit të asistencës teknike, trajnimit dhe pajisjeve.

Pjesa D: Menaxhimi i projektit

Mbështetja e zbatimit të projektit për Nj.Z.P. me ndihmën e asistencës teknike, trajnimit, pajisjeve dhe financimeve të kostove operacionale të shtuara.

* * *

Projekti parashikohet të përfundojë deri në 31 dhjetor 2004.

SHTOJCA 3
PROKURIMI DHE SHËRBIMET E KONSULENTËVE

Seksioni I. Prokurimi i mallrave dhe punimeve

Pjesa A:Në përgjithësi

1. Mallrat sipas Pjesëve C dhe D të projektit do të prokurohen në përputhje me dispozitat e seksionti I të "Udhëzuesve për Prokurimin sipas Kredive IBRD dhe IDA Kredit" të publikuara nga Banka në janar 1995 dhe të rishikuara në janar dhe gusht 1996, shtator 1997 dhe janar 1999, sipas modifikimeve të përcaktuara në paragrafin 2 të Pjesës A (Udhëzuesit) dhe dispozitat e Pjesëve të mëposhtme të seksionit I.

2. Në paragrafet 1.6 dhe 1.8 të Udhëzuesve, referencat për "vendet anëtare të bankës" dhe "vendi anëtar" mendohet t'i referohet respektivisht "Vendeve pjesëmarrëse" dhe "Vendit pjesëmarrës".

Pjesa B:Procedurat Prokuruese

1. Blerja Kombëtare

Mallrat sipas Pjesëve C dhe D të projektit, për shumën në total prej $ 22 000 mund të prokurohen sipas kontratave të fituara duke u bazuar në procedurat e blerjes kombëtare në përputhje me dispozitat e paragrafit 3.5 dhe 3.6 të Udhëzuesve.

Pjesa C:Shqyrtimi nga Shoqata e Vendimeve Prokuruese

1.Post Rishikimi

Në lidhje me çdo kontratë për mallrat sipas Pjesës C dhe D të projektit, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafin 4 të Appendix 1 të udhëzuesve.

Seksioni II. Punësimi i Konsulentëve

Pjesa A. Në përgjithësi

1.Shërbimet e konsulentëve do të prokurohen në përputhje me dispozitat e Hyrjes dhe Seksionit IV të "Udhëzuesve: Zgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore", të botuara nga Banka në janar 1997 dhe të rishikuara në shtator 1997 dhe janar 1999, sipas modifikimeve përcaktuar në paragrafin 2 të kësaj Pjese A (udhëzuesit e konsulentit) dhe dispozitat e pjesëve të mëposhtme të Seksionit II.

2.Në paragrafin 1.10 të Udhëzuesve për konsulentët referimi për "vendet anëtare të Bankës" dhe "vendi anëtar" duhet t'i referohet respektivisht "Vendeve pjesëmarrëse dhe Vendit pjesëmarrës".

Pjesa B:Procedurat për Zgjedhjet e Konsulentëve

1.Zgjedhja e kostos më të ulët

Shërbimet për oditin vjetor të projektit dhe vlerësimet e përfituesit sipas Pjesës D të projektit mund të prokurohen sipas kontratave dhënë në përputhje me dispozitat e paragrafit 3.1 dhe 3.6 të udhëzuesve për konsulentët.

2.Konsulentët individualë

Shërbimet për rregulloren dhe supervisionin e SHKK-së, menaxhimin financiar dhe vlerësimin e projektit sipas Pjesëve C dhe D të projektit do të prokurohen sipas kontratave të dhëna te konsulentët individualë në përputhje me dispozitat e paragrafit 5.1 deri 5.3 të Udhëzuesve për Konsulentin.

Pjesa D:Rishikimi nga Shoqata e Zgjedhjes së Konsulentëve

1.Planifikimi i Zgjedhjes

Para se t'i njoftohet konsulentit ndonjë kërkese për propozim, plani i propozuar për zgjedhjen e konsulentëve sipas Projektit duhet t'i dorëzohet Shoqatës për shqyrtimin ose aprovimin e tij në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të Apendix 1 të Udhëzuesve të Konsulentit. Zgjedhja e të gjitha shërbimeve të konsulentëve duhet të bëhet në përputhje me një plan zgjedhjeje të tillë siç ka qenë aprovuar nga Shoqata, dhe me dispozitat e paragrafit 1 në fjalë.

2.Pararishikimi

(a) Duke marrë parasysh secilën kontratë për punësimin e firmave konsultuese për oditin vjetor të projektit dhe vlerësimeve të përfituesit, parashikuar me një kosto ekuivalent prej $ 25 000 ose më shumë, por më pak se ekuivalenti prej $ 100 000 do aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafin 1,2 dhe (përveç nënparagrafit të dytë të paragrafit 2(a) dhe 5 të Apendix 1 të Udhëzuesve për Konsulentët.

(b) Përsa i përket çdo kontrate për punësimin e konsulentëve individualë parashikuar me një kosto ekuivalent prej $ 25 000 ose më shumë, kualifikimet, përvoja, termat e referencës dhe kushtet e punësmit për konsulentët duhet të dorëzohen te Shoqata për rishikim dhe aprovim. Kontratat do të jepen vetëm mbasi të jetë dhënë aprovimi.

3.Post Rishikimi

Për çdo kontratë që nuk rregullohet nga paragrafi 2 i kësaj Pjese, do të aplikohen procedurat e përcaktuara në paragrafin 4 të Apendix 1 tek Udhëzuesi për konsulentët.

SHTOJCA 4
PROGRAMI I ZBATIMIT, TERMAT DHE KUSHTET E MARRËVESHJEVE NDIHMËSE DHE MARRËVESHJET E KREDIVE

Seksioni I: Programi i zbatimit

1. Huamarrësi:

(a) do të mbështesë gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit Njësinë e Zbatimit të Projektit me një menaxher projekti kualifikimi dhe zbatimi i të cilit duhet të jetë i pëlqyeshëm për Shoqatën dhe i cili do të ndihmohet nga një staf kryesor me një numër të mjaftueshëm të pëlqyeshëm për Shoqatën;

(b) do të mbështesë politikat dhe procedurat e mjaftueshme për të mundësuar atë për të monitoruar dhe vlerësuar, në përputhje me treguesit e pëlqyeshëm për Shoqatën, realizimin e projektit dhe arritjen e objektivave;

(c) do të përgatisë sipas termave të referencës të kënaqshme për Shoqatën dhe të dorëzojë te shoqata në ose rreth 31 tetorit 2001 një raport që paraqet rezultatet e aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit të kryera sipas paragrafit (b) të këtij seksioni, progresin e arritur në kryerjen e projektit gjatë periudhës që i paraprin datës së raportit të sipërmendur dhe përcaktimit të masave të rekomanduara për të siguruar realizmin eficent të projektit dhe arritjen e objektivave gjatë periudhës gjatë periudhës që pason këtë datë dhe;

(d) do të rishikojë me shoqatën, në 31 dhjetor 2001 ose në një datë më të vonë, siç do ta kërkojë shoqata, raportin referuar në paragrafin (c) të këtij seksioni dhe pastaj të marrë të gjitha masat e duhura për të siguruar përfundimin me efikasitet të projektit dhe arritjen e objektivave bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e raportit të përmendur dhe pikpamjet e Shoqatës mbi këtë problem.

Seksioni II: Marrëveshja Ndihmëse I

Për nevojat e Pjesës A të projektit, Huamarrësi do të hyjë në Marrëveshjen Ndihmëse I me FFR, i cili përfshin ndër të tjera, kushtet dhe konditat e mëposhtme:

1. Huamarrësi do të bëjë disponibël te FFR-ja fitimet e Kredisë alokuar nga koha në kohë në kategoritë (1), (3) (a) të pasqyrës përcaktuar në paragrafin 1 të Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2. FFR-ja duhet të kryejë veprimtaritë e tij në përputhje me rregullat themelore të FFR-së dhe sipas procedurave të përcaktuara në manualin operacional të FFR-së dhe në Manualin e Administratës dhe Financës së FFR-së, të cilat duhet të jenë gjatë gjithë kohës të pëlqyeshme për Shoqatën.

3. FFR-ja do të japë Kredi I te SHKK-të e regjistruara sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Seksionin IV të kësaj Shtojce.

4. Kapitali fillestar i Kredisë Ndihmëse I duhet të shlyhet nga FFR-ja te Huamarrësi në Lek të barabarta me këstet 6-mujore mbi 20 vjet, duke përfshirë periudhën favorizuese (grace) prej 5 vjetësh.

5. Kapitali fillestar i Kredisë ndihmëse I i shlyer nga FFR-ja duhet të jetë e barazvlershme në Lek (përcaktuar sipas datës ose datave respektive të tërheqjes nga llogaria e kreditit ose pagesa nga Llogaria e veçantë) me vlerën e monedhës ose monedha ve të tërhequra nga Llogaria e Kredisë sipas kategorisë (1) të pasqyrës së përcaktuar në paragrafin 1 të Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje.

6. Norma e interesit në Kredinë Ndihmëse I do të jetë në nivelin e interesit minimum 6-mujor të depozitave, përcaktuar nga Banka e Shqipërisë minus 6% të tij.

Seksioni III. Marrëveshja Ndihmëse II

Nisur nga qëllimi i Pjesës B të projektit, Huamarrësi hyn në Marrëveshjen Ndihmëse II me FB-në, e cila përfshin ndër të tjera termat dhe kushtet e mëposhtme:

1. Huamarrësi bën disponibël tek FB-ja fitimet e kredisë alokuar nga koha në kohë në kategoritë (2) dhe (3) (b) të pasqyrës përcaktuar në paragrafin 1 të Shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2. FB-ja duhet të kryejë veprimet e tij në përputhje me procedurat e përcaktuara në Manualin e Procedurave të FB-së dhe në Manualin e Administratës dhe Financës së FB, të cilat duhet të jenë gjithmonë të pëlqyeshme për Shoqatën.

3. FB-ja do të sigurojë Nënkredi II për Përfituesit Urbanë me afatet dhe kushtet e përshkruara në Seksionin V të kësaj Shtojce.

4. Shuma e principialit të Kredisë Ndihmëse II do t'i ripaguhet nga FB-ja Huamarrësit në Lek me këste të barabarta gjashtëmujore mbi (15) pesëmbëdhjetë vjet, duke përfshirë një periudhë favorizuese prej pesë (5) vjetësh.

5. Shuma e principialit të Kredisë Ndihmëse I e ripagueshme nga FB-ja do të jetë ekuivalenti në lek (i përcaktuar në datë apo datat respektive, të tërheqjes nga Llogaria e Kredisë ose pagesat e nga Llogaria e veçantë) e vlerës së monedhës apo të monedhave të tërhequra nga Llogaria e Kredisë përsa i përket Kategorisë (2) të tabelës së paraqitur në paragrafin 1 të Kreut 1 të kësaj Marrëveshjeje.

6. Norma e interesit në Kredinë Ndihmëse I do të jetë në nivelin e interesit minimum 6-mujor të depozitave, përcaktuar nga Banka e Shqipërisë minus 5% të tij.

Seksioni IV: Afatet dhe Kushtet e Nënkredisë I

1. Nënkredia I në Pjesën A (3) të Projektit do t'i jepet nga FFR-ja atyre SHKK-ve të cilat përmbushin kriteret e mëposhtme:

(a) janë të regjistruara në përputhje me Ligjin mbi SHKK-në;

(b) mbajnë dokumentet e tyre financiare në përputhje me standardet e pranuara nga Shoqata;

(c) janë trainuar nga FFR-ja apo ndonjë burim tjetër i pranuar nga Shoqata dhe

(d) janë në përputhje me Rregullat Themelore të SHKK-së.

2. Të ardhurat e Nënkredisë I do të përdoren nga SHKK-të e Regjistruara për qëllim huadhënie për Përfituesit Ruralë sipas afatave dhe kushteve të tilla, nëpërmjet të cilave SHKK-të e Regjistruara:

(a) do të vlerësojnë Nënprojektet I dhe mbikqyrin, monitorojnë dhe i raportojnë FFR-së mbi zbatimin e Nënprojekteve I nga Përfituesit Ruralë në përputhje me procedurat e pranuara nga FFR-ja dhe Shoqata;

(b) t'u japin kredi Përfituesve Ruralë në një shumë që në asnjë rast, nuk duhet të kalojë një maksimum prej $ 8000 ekuivalent për çdo Nënprojektet I, të cilat janë: (i) teknikisht të mundshme dhe ekonomikisht, financiarisht dhe komercialisht rentabël; (ii) në përputhje me gjithë ligjet mjedisore dhe standardet e Huamarrësit dhe udhëzimet për vlerësimin mjedisor, për të cilat është rënë dakord me Shoqatën dhe

(c) do të kërkojnë që (i) mallrat, aktivitetet dhe shërbimet që do të financohen në Nënprojektet I nga fitimet e Kredisë të prokurohen me një çmim të arsyeshëm, llogaria të merret gjithashtu nga faktorë të tjerë përkatës siç janë koha e shpërndarjes, efekshmëria, besueshmëria; dhe (ii) këto mallra do të përdoren ekskluzivisht në zbaitmin e Nënprojekteve I.

3. FFR-ja dhe çdo SHKK e Regjistruar do të ushtrojnë të drejtat e tyre në lidhje me Nënkredinë I në mënyrë të tillë, që të mbrojnë interesat e tyre dhe interesat e Huamarrësit dhe të Shoqatës dhe të realizojnë qëllimin e Kredisë.

Seksioni V:Termat dhe Kushtet e Nënkredisë II

Nënkredia II do të jepet me afatet dhe kushtet nëpërmjet të cilave FB-ja:

1. do t'u japë Nënkredi II Përfituesve Urbanë për Nënprojektet II të cilat janë në përputhje me kriteret e specifikuara në Manualin Operacional të FB-së, dhe që janë: (i) teknikisht të mundshme dhe ekonomikisht, financiarisht dhe komercialisht rentabël; dhe (ii) në përputhje me të gjitha ligjet mjedisore dhe standardet e Huamarrësit dhe udhëzimet për vlerësimin mjedisor për të cilat është rënë dakord me Shoqatën;

2. do të vlerësojë Nënprojektet II dhe të mbikqyrë, monitorojë dhe raportojë mbi zbatimin e Nënprojekteve II nga Përfituesit Urbanë në përputhje me procedurat e pranuara nga Shoqata;

3. do të japë Nënkredi II për çdo Përfitues Urban në përputhje me Manualin Operacinal të FB-së, e cila nuk do të kalojë në asnjë rast shumën maksimale prej $ 10.000 për çdo Nënkredi II;

4. do të kërkojë që: (i) mallrat, aktivitetet dhe shërbimet që do të financohen nën Nënprojektet II nga fitimet e Kredisë do të prokurohen me një çmim të arsyeshëm, llogaria e marrë gjithashtu nga faktorë të tjerë përkatës siç është koha e shpërndarjes, efektiviteti dhe besueshmëria dhe (ii) mallra të tilla do të përdoren ekskluzivisht në zbatimin e Nënprojekteve II dhe

5. do të ushtrojë të drejtat e tij në lidhje me Nënkredinë II në mënyrë të tillë që të mbrojë interesat e tij dhe interesat e Huamarrësit dhe të Shoqatës dhe të realizojë qëllimin e Kredisë.

KREU 5
LLOGARIA E VEÇANTË

1. Për qëllimet e këtij Kreu:

(a) termi “kategori të përshtatshme” dmth Kategoritë (1) deri (6) të paraqitura në tabelën në paragrafin 1 të kësaj Marrëveshjeje;

(b) termi “shpenzime të përshtatshme” dmth shpenzime lidhur me koston e arsyeshme të mallrave dhe të shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Kredisë së alokuar herë pas herë në Kategori të përshtashme sipas kushteve të Kreut I të kësaj

Marrëveshjeje; dhe

(c) termi "Alokim i autorizuar" dmth një shumë ekuivalente me $ 800 000 që do të tërhiqet nga Llogaria e Kredisë dhe depozitohet në Llogarinë e Veçantë sipas paragrafit (3) të këtij Kreu.

2. Pagesat nga Llogaria e Veçantë do të bëhen ekskluzivisht për shpenzime të arsyeshme në përputhje me kushtet e këtij Kreu.

3. Pasi Shoqatës i është paraqitur një evidencë e kënaqshme se Llogaria e Veçantë është hapur në kohën e duhur, do të bëhen tërheqjet e Alokimit të Autorizuar dhe tërheqjet pasuese për të rimbushur Llogarinë e Veçantë, si më poshtë:

(a) Për tërheqjet e Alokimit të Autorizuar, Huamarrësi do t'i paraqisë Shoqatës një kërkesë apo kërkesa për depozitë në Llogarinë e Veçantë të një shume ose të shumave, të cilat nuk e kalojnë shumën totale të Alokimit të Autorizuar. Mbi bazën e një kërkese apo kërkesave të tilla, Shoqata, në emër të huamarrësit, do të tërheqë nga Llogaria e Kredisë dhe depozitojë në Llogarinë e Veçantë një shumë apo shumat e kërkuara nga Huamarrësi.

(b) (i) Për rimbushjen e Llogarisë së Veçantë, Huamarrësi do t'i paraqesë Shoqatës kërkesa për depozita në Llogarinë e Veçantë në intervalet që do të specifikojë Shoqata.

(ii) Përpara ose në kohën e çdo kërkese të tillë, Huamarrësi do t'i paraqesë Shoqatës dokumentet dhe evidencat e kërkuara në paragrafin 4 të këtij Kreu për pagesën apo pagesat në lidhje me çdo rimbushje të kërkuar. Mbi bazën e çdo kërkese të tillë, Shoqata, në emër të Huamarrësit, do të tërheqë nga Llogaria e Kredisë dhe depozitojë në Llogarinë e Veçantë shumën e kërkuar nga Huamarrësi dhe të paraqitur në dokumentet dhe evidencat e tjera të paguara nga Llogaria e Veçantë për shpenzimet e arsyeshme. Të gjitha këto depozita do të tërhiqen prej Shoqatës nga Llogaria e Kredisë nën Kategoritë respektive të përshtatshme, dhe në lidhje me shumat ekuivalente të justifikuara nga dokumentet apo evidencat e tjera.

4. Për çdo pagesë të bërë nga Huamarrësi nga Llogaria e Veçantë, Huamarrësi, atëherë kur Shoqata të bëjë kërkesë të arsyeshme, do ti paraqesë Shoqatës dokumente dhe evidenca të tjera të tilla që tregojnë se pagesa të tilla janë bërë ekskluzivisht për shpenzime të arsyeshme.

5. Pavarësisht nga kushtet e paragrafit 3 të këtij Kreu, Shoqatës nuk do t'i kërkohet të bëjë depozita të mëtejshme në Llogarinë e Veçantë:

(a) nëse, në ndonjë rast Shoqata ka vendosur që gjithë tërheqjet e mëtejshme të bëhen prej Huamarrësit direkt nga Llogaria e Kredisë në përputhje me kushtet e Nenit V të Kushteve të Përgjithshme të paragrafit (a) të Seksionit 2.02 të kësaj Marrëveshjeje;

(b) nëse Huamarrësi nuk ka arritur t'i paraqesë Shoqatës, brenda afatit të specifikuar në Seksionin 4.01 (b) (ii) të kësaj Marrëveshjeje, ndonjë nga raportet e auditit të kërkuar për t'iu paraqitur Shoqatës në bazë të Seksionit lidhur me auditin e rekordeve dhe llogarive për Llogarinë e Veçantë;

(c) nëse ndonjë rast Shoqata ka njoftuar Huamarrësin e qëllimit të tij të ndalojë plotësisht apo pjesërisht të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga Llogaria e Kredisë sipas kushteve të Seksionit 6.02 të Kushteve të Përgjithshme; ose

(d) sapo shuma totale e tërhequr e kredisë së alokuar në Kategori të përshtatshme, minus shumën totale të të gjithë angazhimit special të papaguar derdhur nga Shoqata sipas Seksionit 5.02 të kushteve të përgjithshme sipas projektit duhet të barazojë ekuivalentin e dyfishit të shumës së alokimit të autorizuar.

Si pasojë, tërheqja nga Llogaria e Kredisë e shumës së mbetur pa tërhequr të Kredisë së Alokuar në Kategori të përshtashme, do të ndjekë procedura të tilla të cilat shoqata do t'i specifikojë duke njoftuar Huamarrësin. Tërheqje të tilla të mëtejshme vetëm pasi, dhe deri në atë masë që Shoqata do ta shikojë të arsyeshme që shuma të tilla të mbetura në depozitë në Llogarinë e Veçantë deri në datën e një njoftimi të tillë, do të përdoren për të bërë pagesa për shpenzime të arsyeshme.

6 (a) Nëse Shoqata do të vendoste në ndonjë rast që ndonjë pagesë nga Llogaria e Veçantë: (i) do të bëhej për një shpenzim ose në një shumë që nuk përputhet me paragrafin 2 të

këtij Kreu; ose (ii) nuk justifikohet nga evidencat e paraqitura Shoqatës, Huamarrësit sapo të marrë njoftimin nga Shoqata (A) do të sigurojë evidenca shtesë që mund të kërkojë Shoqata; ose (B) do të depozitojë në Llogarinë e Veçantë (ose, nëse Shoqata do të kërkojë, rifinancim për Shoqatën) një shumë të barabartë me shumën e një pagese të tillë apo pjesën jo aq të përshtatshme apo të justifikuar. Nëse shoqata nuk bie dakord, nuk do të bëhet depozitë e mëtejshme nga Shoqata në Llogarinë e Veçantë derisa Huamarrësi ka paraqitur evidencën apo ka bërë një depozitim të tillë apo rifinancim, sipas rastit.

(b) Nëse Shoqata në ndonjë rast ka vendosur që një shumë outstanding në Llogarinë e Veçantë nuk do të kërkohet të mbulojë pagesa të mëtejshme për shpenzime të përshtatshme, Huamarrësi, sapo të marrë njoftimin nga Shoqata, do t'i kthejë Shoqatës një shumë të tillë outstanding.

(c) Huamarrësi mundet që më të marrë njoftim nga Shoqata t'i kthejë asaj të gjithë apo një pjesë të fondit të depozituar në llogarinë e Veçantë.

(d) Kthimet e bëra Shoqatës sipas paragrafit 6 (a), (b) dhe (c) të këtij Kreu do t'i kreditohen Llogarisë së Veçantë për tërheqje të mëvonshme ose për anulim në përputhje me kushtet përkatëse të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë Kushtet e Përgjithshme.